
AKT THEMELIMI DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Tao tao” SHPK

EMËRTIMI – SELIA – KOHËZGJATJA

NENI 1.

KRIJIMI, EMËRTIMI I SHOQËRISË.

1.1 Krijohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “Tao tao” Shpk në vijim e quajtur “Shoqëria”.

1.2. Shoqëria themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar identifikuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 2.

SELIA.

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Tiranë, Rruga Nacionale TR-EL, Qendra Tregtare TEG, katër i dyte **2.2** Me vendim të Asamblesë së Ortakëve mund të hape zyra përfaqësie, degë, dhe/ose të krijoje filiale brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3.

KOHËZGJATJA.

3.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat te papërcaktuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, duke filluar nga rregjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 4.

OBJEKTI I SHOQËRISË.

4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:

Kend lojérash për fëmijë dhe bar kafe

4.2 Për të arritur objektin te saj, Shoqëria, me vendim te Asamblesë mund te realizojë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë çdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare apo të huaja.

4.3 Shoqëria, dhe me qëllim arritjen e objektit te saj, mund të lidhë



marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo ndërmarrje të tjera, si dhe të kryeje çdo veprim tregtar që do ta konsideroje të nevojshëm.

**KAPITALI.
PASURIA DHE FINANCIMI I SHOQËRISË**

**NENI 5.
KAPITALI THEMELTAR.**

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind) Lekë, i ndarë në 1 kuotë. Kapitali mund të zmadhohet ose zvogëlohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**NENI 6.
ORTAKËT.**


6.1 Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortaku i vetëm :

- Ervin Manushi, shtetas shqiptar, i lindur më datë 14.02.1978, në Tiranë, identifikuar me nr dokumenti personal H80214177C, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar. Zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë 100 lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

**NENI 7.
TRANSFERIMI I KUOTAVE.**

7.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme pa miratim paraprak të asamblesë së ortakëve.

7.2 Transferimi i kuotave duhet të realizohet në përputhje me ligjin dhe të regjistrohet në QKB sipas parashikimeve ligjore.



NENI 8.
FINANCIMI I SHOQËRISË.

8.1. Shoqëria me qellim arritjen e objektit te saj, do të kërkojë financimin nëpërmjet mënyrave ligjore si kredi bankare, hua, financim nga ortakët dhe çdo formë tjetër ligjore.

NENI 9.
ORGANET E SHOQËRISË.

9.1 Organet e Shoqërisë janë:

- Administratori,
- Asambleja e Ortakëve.

NENI 10.
ADMINISTRATORËR
FUNKSIONET DHE KOMPETENCAT.

10.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator. Administratori është i autorizuar te kryeje te gjitha veprimet tregtare te shoqërisë pa kufizim kompetencash, përveç atyre qe ligji, akti i themelimit dhe statutija ngarkon Asamblesë se Ortakëve.

10.2 Administratori i shoqërisë kryen administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë. Shoqëria ka si administrator zotin **Ervin Manushi**, shtetas shqiptar, i lindur më datë 14.02.1978, në Tiranë, identifikuar me nr dokumenti personal H80214177C, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

10.3 Administratori ka të gjitha kompetencat për përfaqësuar shoqërinë në marrëdhënie me të tretët. Ai vepron në emër të shoqërisë dhe nënshkruan çdo dokument të shoqërisë. Administratori nuk ushtron kompetencat që ligji ose aktet e shoqërisë ja japid shprehimisht Asamblesë së Ortakëve. Administratori emërohet për një afat 5 vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

10.4 Administratori mund të autorizoj një person të kryejë veprim ne QKB si depozitim aktesh, vendimesh, bilance, statutit dhe çdo akte tjeter.

10.5. Administratori përfiton shpërblim/pagesa për punën e tyre me në masën e përcaktuar me vendim të asamblesë së ortakëve.



10.6. Administratori ka të drejtë ti delegojë aksionerit të gjitha të drejtat sikur të ishte ai vet ne lidhje me të gjitha institucionet financiare, drejtoritë e tatimeve, bankat etj .

NENI 11.

ASAMBLEJA E ORTAKËVE.

11.1. Asambleja e Ortakëve është organi me i larte i shoqërisë dhe vendos për çdo çështje qe ligji ose ky statut ia rezervon asaj. Vendimet e Asamblesë janë te detyrueshme te zbatohen nga organet e shoqërisë.

11.2. Mbledhjet e Asamblesë se Ortakëve organizohen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

11.3. Asambleja zhvillohet ne mënyrë te rregullt dhe vendos ne mënyrë te rregullt sipas kuorumi te parashikuar nga ligji.

11.4. Mbledhjet e Asamblesë zhvillohen normalisht ne selinë e shoqërisë por, me vendim të sajin Asambleja mund te mblidhet edhe ne një vend tjetër brenda ose jashtë Shqipërisë.

11.5. Ortakët njoftohen për mbledhjen e asamblesë te paktën 7 dite përpara dhe duhet te marrin njoftimin per datën, orën, vendin, rendin e ditës dhe te marrin kopjen e dokumenteve që lidhen me rendin e ditës.

11.6. Mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve mund të thirren nga Administratori/administratorët, ose nga subjekte të parashikuar ne ligj.

NENI 12.

VITI FINANCIAR.

12.1. Viti finanziar i shoqërisë fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor.

12.2. Bilanci i shoqërisë mbahet në përputhje me ligjin, miratimi dhe cdo veprim tjetër merret në përputhje me parashikimet ligjore.



NENI 13.
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË.

- 13.1. Procedura e likuidimit e parashikuar ne ligjin nr. 99 01, date 22.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" zbatohet ne rastin e prishjes se shoqërisë.
- 13.2. Shoqëria prishet ne rastet e mëposhtëme: me vendim të asamblesë; me hapjen e procedurave të falimentimit; me vendim gjykate; dhe për çdo arsyetjetër parashikuar në akte të shoqërisë ose në legjislacionin shqiptar.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

NENI 14.
LIGJI I ZBATUESHËM.

- 14.1. Shoqëria do te kryeje veprimtarinë e saj ne përputhje me këtë statut dhe me parashikimet e ligjeve shqiptare. Për sa nuk është parashikuar ne këtë statut do te zbatohet ligji shqiptar nr. 9901, date 22.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".
- 14.2. Ky akt themelimi dhe statut hartohet dhe nënshkruhet ne 5 kopje origjinale sot më 04.02.2022, në Tiranë.

Ortaku

Ervin Manushi

